



**PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE**  
**SEKRETARI PËR ÇËSHTJET LIGJORE DHE ZGJEDHORE**

Nr. 133 Prot

Datë 04.04.2023

**Lënda:** Çregjistrimin e kandidatit Rezeart Tusha, përfaqësues të koalicionit “Bashkë Fitojmë” të regjistruar për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023 nga K.Z.A.Z Shijak në kundërshtim me ligjin.

**Drejtuar:** Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.  
Adresa: Rruga “Ismail Qemali”, Nr.4, Tiranë.

**I nderuar Z.Komisioner,**

Nëpërmjet medias elektronike, subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë është vënë në dijeni të fakteve se kandidati Rezeart Tusha, përfaqësues i koalicionit “Bashkë Fitojmë” në Bashkinë Shijak, është regjistruar në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Zgjedhor dhe ligjin Nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

Më datë 4 Prill 2023 në shtypin e përditshëm është botuar shkrimi sipas të cilit “Kandidati i Sali Berishës për Bashkinë e Shijakut, Rezart Tusha, rezulton i dëbuar nga Zvicra në kuadrin e operacionit “Hydra” në vitin 1997, për posedim të lëndëve narkotike, duke ju ndaluar hyrja në Zvicër për pesë vite, një vepër penale kjo që sipas ligjit të dekriminalizimit të skualifikon nga gara për kryetar bashkie”. Njëkohësisht në artikull theksohet se kandidati “...nuk e ka

*deklaruar këtë në formular...” dhe “ Mosdeklarimi i këtij problemi është vepër penale dhe nga ana tjetër të detyron të ndërpresësh garën për bashki.”<sup>1</sup>*

Sipas të dhënave paraprake të mësipërme, rezulton se Rezeart Tusha është proceduar nga organet e ndjekjes penale dhe gjyqësore për posedim të lëndëve narkotike e më tej është dëbuar nga shteti i Zvicrës, duke i'u ndaluar hyrja në këtë shtet. Ky urdhër ndalimi është publikuar edhe në Sistemin e Informacionit Schengen (SIS II) me qëllim zgjerimin e ndalimit të hyrjes në të gjithë territorin e vendeve anëtare të zonës Schengen.

**Kushtetuta e RSH në nënin 45, pika 3, ka parashikuar se:** *“Përrjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t'u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike”.*

**Ligji Nr. 138/2015, i ndryshuar, në nenin 2, pika 1 ka parashikuar se** *“Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.*  
**Gjithashtu në nënin 2 të pika 2 gërma “b” të ligjit përcaktohet se** *“Ndalimi i parashikuar nga pika 1 e këtij neni, zbatohet edhe ndaj personave që janë dëbuar nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë, në lidhje me një prej rasteve të parashikuara në pikën 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të këtij neni, apo janë dëbuar për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike të shtetit përkatës.”*

**Kodi Zgjedhor, i ndryshuar, në nenin 63, pika 3 ka parashikuar se :** *“Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës dhe që regjistrohet si*

---

<sup>1</sup> <https://www.gazetatema.net/politika/kandidati-i-sali-berishes-per-bashkine-e-shijakut-rezulton-i-debuar-nga-i384680>

*kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie ose për këshillat vendore në K.Z.A.Z.”*

Nëpërmjet kësaj shkrese ne i kërkojmë institucionit tuaj ushtrimin e detyrave funksionale sipas përcaktimeve të nenit 19 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së regjistrimit të kandidaturës Rezeart Tusha përfaqësues të koalicionit “Bashkë Fitojmë” në Bashkinë Shijak dhe më tej të procedojë me vendim për çrregjistrimin e kësaj kandidature.

Në vlerësimin tonë kandidati nuk plotëson në mënyrë kumulative kushtet e prashikuara nga neni 45, pika “3” i Kushtetutës së R.SH.

Kërkojmë që Komisioneri të kryejë një hetim administrativ të plotë, të gjithanshëm dhe sigurisht të shpejtë pasi data e zgjedhjeve 14 Maj 2023 po afron.

Aktualisht K.Q.Z ka rastin që zgjedhësve të Bashkisë Shijak t’u ofrohet për zgjedhje një kandidaturë që të garantojë “...besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore...”<sup>2</sup> dhe në këtë kuadër kandidati Rezeart Tusha nuk ofron aspak këtë garanci të parashikuar në ligj.

Ndërprerja e kandidimit duke bërë cregjistrimin në këtë fazë, në një eventualitet, *mbron dhe garanton mirëfunksionimin demokratik të organeve të qeverisjes vendore.*

#### **SEKRETARI PER ÇËSHTJET LIGJORE DHE ZGJEDHORE**

**ERIDIAN SALIANJI**



<sup>2</sup> Neni 1, pika 1 e ligjit Nr. 138/2015, i ndryshuar.